

UNIVERSITETI I PRISHTINËS

"HASAN PRISHTINA"

FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT



PUNIMI I DIPLOMËS – MASTER

**NDRYSHIMET NË ZHVILLIMIN MORFOLOGJIK DHE MOTORIK TE
NXËNËSIT NGA MOSHA 12 DERI 15 VJEÇARE**

MENTORI:

Prof.Ass. Shqipe Bajqinca

KANDIDATET:

Donika Thaçi

Edonë Godanci

Prishtinë, 2016

PËRMBAJTJA

1. HYRJE.....	4
2. QËLLIMI DHE DETYRAT E PUNIMIT.....	9
3. HIPOTEZAT THEMELORE.....	10
4. METODOLOGJIA E PUNËS.....	11
4.1. MOSTRA E ENTITETIT.....	11
4.2. MOSTRA E NDRYSHOREVE.....	12
4.2.1. Ndryshoret antropometrike.....	12
4.2.2 Variablat motorike.....	12
4.3 KUSHTET E MATJES.....	13
4.4 MJETET MATËSE ANTROPOMETRIKE.....	14
4.5 PËRSHKRIMI I INSTRUMENTËVE MATËSE.....	15
4.5.1 Përshkrimi i instrumenteve matëse antropometrike.....	16
4.5.2 Përshkrimi i instrumenteve matëse motorike.....	28
4.6 METODAT E PËRPUNIMIT TË REZULTATEVE.....	33
5. INTERPRETIMI DHE DISKUTIMI.....	34
5.1 INTERPRETIMI I PARAMETRAVE THEMELOR STATISTIKOR.....	34
5.1.1 Interpretimi i parametrave themelor statistikor ndryshoreve antropometrike te fëmijët e moshës 12 vjeçare të gjinisë mashkullore.....	34
5.1.2 Interpretimi i parametrave themelor statistikor ndryshoreve antropometrike te fëmijët e moshës 12 vjeçare të gjinisë femërore.....	35
5.1.3 Interpretimi i parametrave themelor statistikor ndryshoreve antropometrike te fëmijët e moshës 13 vjeçare të gjinisë mashkullore.....	36
5.1.4 Interpretimi i parametrave themelor statistikor ndryshoreve antropometrike te fëmijët e moshës 13 vjeçare të gjinisë femërore.....	37
5.1.5 Interpretimi i parametrave themelor statistikor ndryshoreve antropometrike te fëmijët e moshës 14 vjeçare të gjinisë mashkullore.....	38
5.1.6 Interpretimi i parametrave themelor statistikor ndryshoreve antropometrike te fëmijët e moshës 14 vjeçare të gjinisë femërore.....	39
5.1.7 Interpretimi i parametrave themelor statistikor ndryshoreve antropometrike te fëmijët e moshës 12 vjeçare të gjinisë mashkullore.....	40

5.1.8 Interpretimi i parametrave themelor statistikor ndryshoreve antropometrike te fëmijët e moshës 12 vjeçare të gjinisë femërore.....	41
5.2 DALLIMI SIPAS GRUPMOSHAVE DHE GJINISË TE NDRYSHORET ANTROPOMETRIKE DHE MOTORIKE	42
5.2.1 Dallimi sipas grupmoshave te meshkujt te ndryshoret antropometrike.....	42
5.2.2 Dallimi sipas grupmoshave te meshkujt te ndryshoret motorike.....	49
5.2.3 Dallimi sipas grupmoshave te femrat te ndryshoret antropometrike	53
5.2.4 Dallimi sipas grupmoshave te femrat te ndryshoret motorike.....	60
5.3 VËRTETIMI I HIPOTEZAVE	64
6. PËRFUNDIMI.....	65
7. LITERATURA.....	67

1. HYRJJE

Faktorët biologjik - Dimensionet morfologjik edhe aftësitë motorike, gjatë jetës tek çdo individ pa ndërprerë ndryshojnë më shumë ose më pak. Këto ndryshime nuk ndodhin ekskluzivisht për shkak të ndikimit të rrethit të jashtëm por janë pasojë e pjesërishme e veprimit të faktorëve biologjik të cilët në organizëm gjenden që nga fillimi i jetës. Ndikimi i faktorëve biologjik në kushte reale të jetës hyn në bashkëveprim me faktorët tjerë dhe sjell deri tek plakja graduale e cila nuk do të thotë se një plakje graduale ndodh me shpejtësi të njëjtë në të gjitha pjesët e organizmit. Të plakurit është proces biologjik, i cili nuk do të thotë se shkon gjithmonë në mënyrë paralele me numrin e viteve të jetuara. Periudha e plakjes është dukuri e pashmangshme e kushtëzuar me kalimin e kohës në të cilën nuk mundë të kemi asnjë ndikim. Plakja biologjike mundë të përputhet me periudhën e moshës kalendarike, mirëpo, me veprimin e faktorëve të ndryshëm mundë të shpejtohet ose të ngadalësohet, çka rezulton me një shmangie të caktuar të rëndësishme ose të pa rëndësishme ndërmjet moshës dhe plakjes biologjike. Mospërputhja ndërmjet numrit të viteve të jetuara dhe plakjes së organizmit është e lartësisë së ndryshme nga një individ tek tjetri, mirëpo, mundë të ndryshohet edhe tek i njëjti njeri në periudha të caktuara kohore të jetës.

Jetën biologjike mundë ta ndajmë në këto etapa:

- a) Fazën e evolucionit ose zhvillimit, e cila karakterizohet me rritjen e dimensioneve trupore, aftësive funksionale, motorike dhe të tjera.
- b) Fazën e stagnimit relative, e cila kryesisht zgjat gjatë dhe karakterizohet me një stabilizim relativ morfologjik, funksional dhe motorik. Në këtë faze proceset e plakjes biologjike janë prezentë, mirëpo, aftësitë funksionale dhe motorike nuk ndryshojnë dukshëm.
- c) Faza e involucionit ose plakjes së dukshme mund të paraqitet dhe të rrjedh më shpejt ose më ngadalë, dhe karakterizohet me zvogëlim të dukshëm të aftësive funksionale dhe motorike të organizmit.

Njohja e strukturave të disa dimensioneve të statusit psikosomatik të nxënësve (sidomos atij morfologjik), me këte edhe të zhvillimit e tyre, paraqet kushtin themelor

për udhëheqje të drejt me procese kinesiolgjike drejt zhvillimit të gjithanshëm të rinisë. Duke iu falënderuar hulumtimeve të shumta në të cilat janë angazhuar në vërtetimin e strukturës së disa pjesëve të hapësirës psikosomatike, në shkallën e tashme të zhvillimit të shkencës në kulturën fizike, me bindje dhe siguri të plotë mund të flasim mbi ekzistimin e karakteristikave të ndryshme antropometrike si dhe të aftësive dhe veçorivetë ndryshme.

Definimi i konstitucionit të njeriut e sidomos i sportistit është shumë kompleks për shkak të disa faktorëve të cilët në mënyrë direkte ndikojnë në veçoritë morfologjike, fiziologjike, biokimike dhe psikike të tij. Vet reaktioni i organizmit si tërësi në disa ngacmime respektivisht sjellje në situata të ndryshme të jetes dhe punës përbëjnë grupin e të gjitha veçorive morfologjike, fiziologjike, biokimike dhe psikike të cilët japin karakter konstitucionit të njeriut respektivisht paraqet fenotipin i cili zhvillohet si simbioza e gjenotipit të caktuar i cili është nën ndikimin e faktorëve kompleks të jashtëm.

Shumë autorë dukurin apo nocionin e gjenotipit shpesh e kanë identifikuar me konstitucionin trupur. Mirëpo nocioni i konstitucionit është shumë më i gjerë dhe plastik dhe vet mundësia e formimit në kushte të rrethit në të cilën njeriu jeton, nën veprimin e mënyrës së të jetuarit, punës dhe edukimit na orjenton neve që të kuptojmë se në konstitucionin e njeriut ndikim fundamental kanë faktorët e brendshëm dhe të jashtëm të zhvillimit të njeriut.

Antropometrija (somatometrija) është metodë e matjes e trupit të njeriut, respektivisht të disa pjesëve të trupit, me të cilën në mënyrë kuantitative përcaktohen veçoritë morfologjike dhe shikohet pasqyra objektive e gjendjes dhe zhvillimit të njeriut. Antropologjia morfologjike është metodë e cila përfshinë matjet e trupit të njeriut, përpunimin dhe studimin e matjeve të fituara. Në sporte të ndryshme si ato amatore ashtu edhe kulminante kjo shërben për:

- Selekcionimin e kandidatve për çdo sport
- Përcjelljen dhe evaulimin e procesit stërvitor
- Vlerësimin objektiv e zhvillimit të përgjithshëm të trupit

- Kontrollimit të gjendjes së ushqyeshmërisë së sportistit
- Përcjelljen e çlodhjes së sportistit në procesin e rehabilitimit

Rëndësia e ndërtimit të trupit për sportet kulminante nuk është e definuar në tërësi si parakusht për arritjen e rezultateve kulminante në sportet kulminante. Prap se prap, hulumtimet kanë treguar se sportistët e suksesshëm tregojnë ngjajshmëri në ndërtimin dhe në raportin e masës yndyrore dhe jo yndyrore trupore, dhe këto shprehen më shumë duke përparuar dmth. duke arritur kategori gjithë e më të larta në sportin kulminant. Sipas kësaj, sportistët kulminant, shikuar në aspektin morfologjik janë grupë relativisht homogjene, varësisht nga sporti, është i mundur të definohet modeli i cili dëshirohet të arrihet ashtu që të arrihen rezultate kulminante.

Faktorët e rrethit ku hyjnë: pozita sociale (kushtet e vendbanimit, kushtet e shkollimit dhe qëndrimit në hapësirat e shkollës, pozita materiale e familjes, kushtet higjienike, kujdesi shëndetësor) ambienti i pastër si dhe faktorë tjerë të rrethit, si në vendbanimet urbane njashtu edhe në ato rurale (si faktorë ekzogjen) kanë ndikim të rëndësishëm si në zhvillimin morfologjik, ashtu edhe në zhvillimin e aftësive funksionale dhe motorike. Faktorët social dhe faktorët tjerë të rrethit si faktorë të mikrorrethit mundë ti ndajmë në:

- a) Faktorë social (kushtet e banimit, shkollimit, pozita materiale, kushtet higjienike, kujdesi shëndetësor, e tjera).
 - b) Mikroklimatik (temperature, lagështia, përbërja e ajrit, shpejtësia e rrymimit, papastërtia e atmosferës dhe të ngjashme)
 - c) Mekanike (zhurma, vibracionet)
 - d) Optike (ndriçueshmëria, karakteristikat e burimeve të ndriçimit, kontrastet, ngjyrat e tjera)
- Radiacioni (Valët elektromagnetike të gjatësive të ndryshme)

White (1982.) ka arrit në përfundimin se statusi socio-ekonomik (SES) që është përcaktuar me matje tradicionale (niveli i të ardhurave, nivelit arsimor dhe statusi i punësimit të kryefamiljarit) pozitivisht, por dobët (jo mjaftueshëm) është i lidhur ($r = 0,22$), me matjet e arritjeve të njohurive dhe zhvillimit harmonik trupor të fëmijës, ndërsa karakteristikat e familjeve, si klima në familje, kanë treguar lidhje të fuqishme me arritjen

e njohurive të fëmijët e kësaj moshe. Megjithatë, qëndrimet e prindërve rreth edukimit, sjelljet prindërore, aktivitetet kulturore, aktivitetet intelektuale dhe aktivitetet fizike të familjes, nga të cilat shpesh është përcaktuar klima familjare, nga njëherë në mënyrë të pasaktë janë marrë si matje e statusit socio-ekonomik të familjeve.

Një nga detyrat prioritare në punën me fëmijët e moshës parashkollore ka të bëjë me kujdesin dhe zhvillimin harmonik e tyre optimal. Që të zhvillohet ky proces në mënyrë të duhur, pjesëmarrësit në punën edukative dhe arsimore do të duhet të marrin parasysh ndërveprimin e dimensioneve të ndryshme antropologjike dhe zhvillimin e tyre integral.

Me termin rritja normale zakonisht kuptojmë rritjen kuantitative të peshës dhe madhësisë dhe ndryshime cilësor në formimin e trupit të fëmijëve. Proceset e rritjes dhe zhvillimit të fëmijëve janë në ndërveprim, dhe është e nevojshme të dijmë jo vetëm nivelet sasiore, por edhe natyrën e marrëdhënieve morfologjike dhe aktivitetet fizike të fëmijëve, në moshë të caktuar, si dhe sipas gjinisë.

Ekspozimi me stimuj të shumëllojshëm (aktivitete fizike, faktor nutritiv, social e tjerë) në mënyrë të pa evitueshme çon në një ndikim më të madh apo më të vogël në dimensionet latente të sistemit antropologjike, si në aspektin sasior ashtu dhe cilësor. Pra Breckenridge, M.E. dhe E.L. Vicent (1960) sqarojnë emocionin e "zhvillimit integral dhe harmonik trupor" në këtë mënyrë: "Fëmija përbëhet prej shumë pjesëve që veprojnë në mënyrë të integruar në mes veti. Aftësitë e tij intelektuale janë të lidhur me shëndetin dhe zhvillimin harmonik fizik; Emocionet ndikojnë fuqishëm në shëndetin fizik; Suksesi shkollor ose dështimi, shëndeti fizik ose aftësitë intelektuale ndikojnë në emocione. Përkujdesi ndaj shëndetit fizik dhe zhvillimit të drejt, aftësitë motorike, funksionale dhe intelektuale, interesi për aktivitete fizike dhe liria emocionale janë kërkesa që duhet të përmbushën në institucione parashkollore që thellë dhe përherë ndikojnë në zhvillimin harmonik trupor të fëmijës".

Rritja dhe zhvillimi i fëmijëve ka një vend të rëndësishëm në studimin e përgjithshëm të statusit antropologjik të fëmijëve, si nga pikëpamja e antropologjisë biologjike, ashtu dhe

nga pikëpamja e shkencave mjekësore, fiziologjisë, psikologjisë, dhe veçanërisht Kineziologjisë.

Aplikimi i aktiviteteve të organizuara në kohën e lirë të fëmijëve si faktor i rëndësishëm i zhvillimit të drejt dhe harmonik trupor, ka çuar në faktin se fëmijët në kohën e sotme, ndoshta më shumë se kurrë, varen nga potenciali ekonomik dhe kulturor i familjeve të tyre. Prindërit, si dhe mjedisi, kanë një ndikim të madh në zhvillimin e gjithanshëm të fëmijëve, dhe për këtë arsye kanë një përgjegjësi të madhe si në zhvillimin psikofizik dhe motorik të tyre, ashtu edhe në aspektin edukativ dhe arsimor.

2. QËLLIMI DHE DETYRAT E PUNIMIT

Njohurit mbi zhvillimin morfologjik dhe motorik të nxënësve në periudhën e hershme të adoleshencës duhet të paraqet një ndër preokupimet kryesore të të gjitha institucioneve të Republikës së Kosovës, pastaj, Profesorëve të Edukimit Fizik, trajnerëve dhe prindërve. Nga një pasqyrë e till varet edhe niveli shëndetësor, social dhe sportiv i një shoqërie.

Problemi i këtij hulumtimi paraqet analizimin i disa parametrave morfologjik dhe motorik të nxënësve të moshës nga 12 deri në moshën 15 vjeçe.

Qëllimi i këtij punimi është të përcaktohet niveli i zhvillimit morfologjik dhe motorik i nxënësve të moshës nga 12 deri në moshën 15 vjeçe domethënë zhvillimit morfologjik dhe motorik i nxënësve nëpër periudha kohore të rritjes dhe zhvillimit.

Detyrat – Për realizimin e qëllimit të parashtruar, janë parashtruar këto detyra të hulumtimit:

- Të përcaktohet niveli i zhvillimit morfologjik nëpër periudha kohore të rritjes dhe zhvillimit të nxënësve të dy gjinive
- Të përcaktohet niveli i zhvillimit motorik nëpër periudha kohore të rritjes dhe zhvillimit të nxënësve të dy gjinive.
- Të krahasohen rezultatet e matjeve të zhvillimit morfologjik nëpër periudha kohore të rritjes dhe zhvillimit të nxënësve të dy gjinive
- Të krahasohen rezultatet e matjeve të zhvillimit motorik nëpër periudha kohore të rritjes dhe zhvillimit të nxënësve të dy gjinive
- Të krahasohen rezultatet e matjeve të zhvillimit morfologjik nëpër periudha kohore të rritjes dhe zhvillimit të nxënësve në mes të dy gjinive
- Të krahasohen rezultatet e matjeve të zhvillimit motorik nëpër periudha kohore të rritjes dhe zhvillimit të nxënësve në mes të dy gjinive

3. HIPOTEZAT THEMELORE

Në bazë të lëmisë dhe problemit të hulumtimit dhe në përputhje me qëllimin dhe metodat statistikore për përpunimin e rezultateve formulohen dhe parashtrihen këto hipoteza:

H₀₁ – Distribucioni i fituar i ndryshoreve antropometrike të të gjitha moshat dhe gjinitë të aplikuara në këtë punim nuk do të ketë shpangie nga distribucioni normal.

H₀₂ – Distribucioni i fituar i ndryshoreve motorike të të gjitha moshat dhe gjinitë të aplikuara në këtë punim nuk do të ketë shpangie nga distribucioni normal.

H₀₃ – Dallimet në mes nxënësve të ndarë sipas moshës në matjet antropometrike do të jenë statistikisht të rëndësishme. ,

H₀₄ – Dallimet në mes nxënësve të ndarë sipas moshës në vlerësimin e aftësive motorike do të jenë statistikisht të rëndësishme

H₀₅ –Dallimet në mes nxënësve të ndarë sipas gjinisë në matjet antropometrike do të jenë statistikisht të rëndësishme. ,

H₀₆ – Dallimet në mes nxënësve të ndarë sipas gjinisë në vlerësimin e aftësive motorike do të jenë statistikisht të rëndësishme.

4. METODOLOGJIA E PUNËS

4.1. MOSTRA E ENTITETIT

Në këtë punim (hulumtim) janë përfshirë 120 nxënës të gjinisë mashkullore dhe 120 nxënës të gjinisë femrore, gjithsejt në hulumtim janë përfshirë 240 nxënës të Shkollës fillore të mesme të Ulët, "Dëshmorët e Kombit", " në Kamenicë. Nxënësit e dy gjinive kanë qenë të ndar në 4 grupe. Grupin e parë ka qenë i përbërë prej 30 nxënësve të gjinisë mashkullore dhe 30 nxënësve të gjinisë femrore të moshës 12 vjeçe (klasëve të gjashta - VI), grupi e dytë prej 30 nxënësve të gjinisë mashkullore dhe 30 nxënësve të gjinisë femrore të moshës 13 vjeçe (klasëve të shtata - VII), grupin e tretë prej 30 nxënësve të gjinisë mashkullore dhe 30 nxënësve të gjinisë femrore të moshës 14 vjeçe (klasëve të teta- VIII), grupin e katërtë prej 30 nxënësve të gjinisë mashkullore dhe 30 nxënësve të gjinisë femrore të moshës 15 vjeçe (klasëve të nënta - IX

Të gjithë nxënësit rregullisht kanë vijuar procesin mësimor, dhe kanë realizuar detyrat e parapara me programin e edukatës fizike, dhe të gjithë kanë qenë të gatshëm në aspektin e zhvillimit fizik t'i nënshtrohen matjeve për qëllimin e këtij punimi.

Organizimi i matjeve është bërë gjatë muajit prill dhe maj të vitit 2015 në sallën e Shkollës fillore të mesme të Ulët, "Dëshmorët e Kombit", " në Kamenicë në orët e paraditë

4.2. MOSTRA E NDRYSHOREVE

4.2.1. Ndryshoret antropometrike

Për identifikimin e karakteristikave morfologjike janë aplikuar këta parametra antropometrik:

1. Lartësia e trupit..... ALARTË
2. Gjerësia e krahëve..... AGJEKR
3. Gjatësia e këmbësAGJAKË
4. Pesha e trupit.....APESHA
5. Perimetri i gjoksit.....APEGJO
6. Perimetri i krahutAPEKRA
7. Diametri i bylyzykut..... ADIBYL
8. Diametri i bërrylit.....ADIBRY
9. Diametri i gjuritADIGJU
10. Indi dhjamor nën lëkuror i shpinës.....AIDHSH
11. Indi dhjamor nën lëkuror i krahut..... AIDHKR
12. Indi dhjamor nën lëkuror i barkut.....AIDHBA

4.2.2 Variablat motorike

Për identifikimin e aftësive motorike janë aplikuar këta parametra motorik:

1. Vrapim 30 metra nga starti i lartë.....MSVR30L
2. Kërcim së gjati nga vendiMFKGJVE
3. Tapingu me dorë.....MSTDORË
4. Tetëshe me përkuljeMATEPËR
5. Fleksibilitet përkulje e trupit paraMFPPARA

4.3 KUSHTET E MATJES

Gjatë matjeve do të kemi parasyshë që:

1. Matjet antropometrike të jenë ekzekutuar në orët e para të pasdites.
2. Instrumentet matëse të jenë të punimit standard të jenë të rregulluara së paku çdo ditë para matjeve.
3. Vendi ku janë ekzekutuar matjet do të ketë hapsirë e mjaftueshme dhe e ndriçuar mirë, ndërsa temperatura e ajrit do të jetë rreth 22⁰.
4. Në vendin ku janë ekzekutuar matjet (sallë e edukatës fizike) kanë qenë pesë matës, shkruesi i rezultateve dhe grupi prej pesë të testuarve të cilët janë zëvendësuar pas matjes.
5. Të testuarit para matjes kanë qenë zbathur dhe vetëm në brekë.
6. Në çdo të testuar, para matjes, janë përcaktuar dhe shënuar në mënyrë të saktë nivelet dhe pikat antropometrike të cilat kanë qenë në programin e matjeve.
7. Dimensionet e caktuara antropometrike çdo herë i ka matur i njëjti testues. Rezultatet e matjes janë lexuar gjatë kohës deri sa testuesi ka matur, ndërsa personi i cili shkruar rezultatet për ti kontrolluar i ka përsëritur rezultatet me zë të qart.
8. Matjet e segmenteve çift të trupit janë ekzekutuar në anën e majtë të trupit.
9. Matjet antropometrike të jenë përsëritur nga tri herë

4.4 MJETET MATËSE ANTROPOMETRIKE

Për aplikimin e këtij programi të matjeve janë shfrytëzuar këto mjete antropometrike:

1. Peshorja (transportabile) e cila mundëson matjen me saktësi prej 0,5 kg dhe tek e cila ekziston mundësia. Peshorja bazhdohet çdo ditë para përdorimit dhe pas çdo dhjet matjeve.



2. Antropometri sipas Martinit (në të cilën matja bëhet në centimetra dhe milimetra)



3. Traka matëse prej materiali të plastikës me gjatësi prej 150 cm (në të cilën janë të shënuara centimetrat dhe milimetrat).



- 4 Kaliperi për matjen e trashësisë së indit dhjamor nënlëkuror i tipit “John Bull”, i përshtatur që shtypja e majeve të akrepave të kaliperit në lëkur të jetë 10 gr/mm². Në shkallën e kaliperit janë të shënuara centimetrat dhe milimetrat. Shkalla më e vogël e matjes është 0,2 mm.



4.5 PËRSHKRIMI I INSTRUMENTËVE MATËSE

4.5.1 Përshkrimi i instrumenteve matëse antropometrike

Variablat antropometrike* janë matur sipas mënyrës siç vijon:

1. Lartësija e trupit (ALARTË) – matet me antropometer, entiteti që matet duhet të jetë i zbathur në brekë sportive të qëndroj në bazë të fortë horizontale. Koka e tij duhet të jetë në pozitë ku duhet rrespektuar horizontalja e frankfurtit. Qendrimi i trupit te entitetit duhet te jeti i relaksuar dhe i drejt , nderkaq matesi qendron ne anen e majt te entitetit . pasi qe e kontrollon poziten e entitetit dhe te instrumentrit (antropometrit) , eleshon krahum horizontal te antropometrit deri ne pjesen parietale te kokes (pika me e lart e kokes – vertex). Rezultati lexohet me saktesi 0.1 cm.

Foto 1. Lartësija e trupit



* Të gjitha matjet janë ekzekutuar sipas metodës të cilën e ka propozuar IPB (International Biologic Program) Programi biologjik ndërkombëtar. PBN (Programi biologjik ndërkombëtar) ka përgatitur listën e matjeve antropometrike duke pasur parasysh nevojën e atyre që merren me hulumtime të karakteristikeve të trupit të njeriut në kushte të ndryshme e që shpesh nuk janë antropolog. Nga lista e matjeve antropologjike të propozuara nga Programi biologjik ndërkombëtar, gjithsejtë 39 matje, për nevojat e këtij hulumtimi janë përdorur 6 matje antropometrike. Parametrat e treguesve antropometrik maten sipas procedurës të cilat i kanë (në bazë të propozimit të autorit Stoudt dhe Mc Farlanta) përpunue M.Stojanoviç i Z.Stojkovië.

2. Gjerësia e krahëve (AGJEKR) - matet me antropometer i testuari qendron me duar te haupra horizontalisht ne nivel te kraheve, dhe me shuplaka te kthjera perpara . matja kryhet nga daktilioni i dores se djatht deri tek daktilioni i dores se majt ,rrezulltati lexohet me saktesi 0.1 cm.

Foto 2. Gjatesia e kraheve te shtrir (AGJEKR)



3. Gjatësia e këmbës (AGJAKË) – i eksperimentuari duhet të qendroj sikurse në matjen e lartesis së trupit, matje është kryer me sherit centimetrik nga dyshemeja ku qendron entiteti deri te pika e quajtur “gjembi i siperm i perparm i çopokut” në anën e majtë të këmbës. Rezultati lexohet me saktësi 0.1 cm.

Foto 3. Gjatësia e këmbës (AGJAKË)



4. Pesha e trupit (APESHA) – matet me peshore decimale me saktësi deri në 0.1kg. Peshorja vendoset në sipërfaqe të rrafshet. I testuari vendoset në mes të peshorës duke marrë pozicioni i drejtë. Gjatë matjes kanë të veshur me veshje sportive (vetëm në brekë) dhe pas se ciles matje peshorja kthehet ne zero (0)

Foto 4. Pesha e trupit (APESHA)



5. Perimetri i gjoksit (APEGJO) – është matë me traken matëse plastike. Para matjes i testuari është i zbathur, në brekë dhe qëndron në drejtpëndrim me duar të lëshuara nga poshtë. Traka matëse mbështjellët rreth gjoksit në një pozitë horizontale ndaj boshtit të trupit, duke kaluar horizontalisht nëpër pikat e lidhjes së brinjëve 3. dhe 4. për kockën e gjoksit. Rezultat i matjes lexohet atëherë kur kafazi i kraharorit është në pozitë mesatare (në fund të ekspiriumit normal, respektivisht, në pauzë ndërmjet inspirimit dhe ekspirimit). Rezultati lexohet me saktësi prej 0,1 cm

Foto 5. Perimetri i gjoksit (APEGJO)



6. Perimetri i krahut (APEKRA) – është matë me traken matëse prej plastike. Para matjes i testuari është i zbathur dhe në brekë dhe qëndron në drejtqëndrim me duar të lëshuara nga poshtë. Traka matëse mbështjellët rreth krahut të majtë (pjesës më të trashë) në boshtin e tij në nivel i cili i përgjigjet mesit ndërmjet akromionit dhe olekranonit. Rezultati lexohet me saktësi prej 0,1 cm.

Foto 6. Perimetri i krahut (APEKRA)




7. Diametri i bylyzykut (ADIBY) – diametri bylyzykut është matë me nanous. Gjatë matjes i testuari është në brekë dhe i zbathur dhe qëndron në drejtqëndrim me krah të lakuar në kënd të drejt. Majet e akrepave të nanousit vendosen në pjesën e brendshme dhe të jashtme të epykondilusave të parallërave me presion të mjaftueshëm që të largohet indi i butë. Rezultati lexohet me saktësi prej 0,1 cm.

Foto 7. Diametri i bylyzykut (ADIBY)



8. Diametri i bërrylit (ADIBRY) – (diametri bikondilar i krahut) është matë me nanous. Gjatë matjes i testuari është në brekë dhe i zbathur dhe qëndron në drejtqëndrim me krah të lakuar në kënd të drejt. Majet e akrepave të nanousit vendosen në pjesën e brendshme dhe të jashtme të epykondilusave të krahut me presion të mjaftueshëm që të largohet indi i butë. Rezultati lexohet me saktësi prej 0,1 cm.

Foto 8. Diametri i bërrylit (ADIBRY)



9. Diametri i gjurit (ADIGJU) – (diametri bikondilar i kofshës) është matë me nanous. Gjatë matjes i testuari është i zbathur dhe në brekë, qëndron i ulur. Këmba e majtë është e lakuar në këndë të drejtë në gju. Majet e akrepit të nanousit vendosën në pjesën e brendshme dhe të jashtme të epikondilusit të femurit me një presion të mjaftueshëm që indi i butë të largohet. Rezultati lexohet me saktësi prej 0,1 cm.

Foto 9. Diametri i gjurit (ADIGJU)



10. Indi dhjamor nën lëkuror i shpinës (AIDHSH) – (nën këndin e poshtëm të shpatullës) dhe është matë me kaliper. Para matjes i testuari është i zbathur dhe në brekë dhe qëndron në drejtqëndrim me duar të lëshuara nga poshtë. Testuesi me gishtin e madh dhe gishtin tregues të dorës së majtë horizontalisht kap lëkurën drejtpërdrejt nën këndin e poshtëm të shpatullës së majtë, duke pasur kujdes që të mos kap indin muskolor, kap palën (rrudhën) e lëkurës me majat e akrepave të kaliperit. Rezultati lexohet me saktësi prej 0,2 mm.

Foto 10. Indi dhjamor nën lëkuror i shpinës(AIDHSH)



11. Indi dhjamos nën lëkuror i krahut (AIDHKR) – është matë me kaliper. Para matjes i testuari është i zbathur, në brekë qëndron në drejtqëndrim me duar të lëshuara nga poshtë. Testuesi me gishtin e madh dhe gishtin tregues të dorës së majtë vërtikalisht kap lëkurën drejtpërdrejt në pjesën e mbrapme të krahut të majtë (tek muskuli triceps) në vendin e cila i përgjigjet mesit ndërmjet akromionit dhe olekranonit, duke patur kujdes që most ë kapet indi muskolor, kap palën (rrudhën) e lëkurës me majet e akrepave të kaliperit (të vendosur më poshtë se majet e gishtrinjëve. Rezultatet lexohen me saktësi prej 0,2 mm.

Foto 11. Indi dhjamos nën lëkuror i krahut (AIDHKR)



12. Indi dhjamor nën lëkuror i barkut (AIDHBA) – është matë me kaliper. Para matjes i testuari është i zbathur, në brek dhe qëndron në drejtëqëndrim me duar të lëshuara nga poshtë dhe relaksim të muskujve të barkut. Testuesi me gishtin e madh dhe gishtin tregues të dorës së majtë horizontalisht kap lëkurën në anën e majtë të barkut në nivel të kërthizës (ombilikusit) dhe 5 cm në të majtë nga ai, duke patur kujdes që të mos kap edhe inde muskulore , kap palën (rrudhën) me majet e akrepave të kaliperit (të vendosur medialisht nga majet e gishtrinjëve). Rezultati lexohet me saktësi prej 0,2 mm

12. Indi dhjamor nën lëkuror i barkut AIDHB



4.5.2 Përshkrimi i instrumenteve matëse motorike

1. Vrapim 30 metra nga starti i lartë – MV30m

Instrumentet: Kronometri me 1/10 sek.

Përshkrimi i detyrës:


Pozita fillestare: I testuari përgatitet për vrapim pranë vijës së startit, në pozitë të startit të lartë:

Realizimi i detyrës: Pas komandës “gati” nga matësi ndihmës, dhe sinjalit “tash”, i testuari me shpejtësi maksimale vrapon gjatësinë e shtegut 40m.

Vlerësimi: Matet koha nga dhënia e sinjalit nga matësi ndihmës, deri në momentin kur i testuari kalon me trung vijën e paramenduar me vijën e cakut. Koha matet në saktësi 1/10 sec.

Udhëzime të testuarit: Në rast të startit jo të rregullt, vrapimi përsëritet. Të testuarit udhëzohen që pas arritjes në vijën e cakut të vazhdojnë vrapimin edhe për disa metra, duke u ndalur në mënyrë graduale.

Foto 13. Vrapimi 30 metra nga starti i lartë (MV30m)



8. Kërcim së gjati nga vendi (MKGJAT)

Instrumentet: Metri metalik i vendosur në dy anët e vendit për kërcim.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari qëndron i kthyer me fytyrë kah drejtimi i kërcimit në pozitë drejtëqëndrimi me këmbë të thyera në gjuhë që mundëson kërcim më të sukseshëm.

Realizimi i detyrës: I testuari kërcen tri herë, duke përsëritur kërcimet njërin pas tjetrit.

Matet gjatësia e kërcimit prej vijës shtytëse e deri te gjurmët e shputave

(pjesa fundore). Rezultati shënohet me saktësi prej 1 cm.

Vlerësimi: Matet gjatësia e kërcimit prej vijës shtytëse e deri te gjurmët e shputave (pjesa fundore). Rezultati shënohet me saktësi prej 1 cm.

Udhëzime të testuarit: Të testuarave udhëzimet iu janë dhënë gjatë demonstrimit të detyrës, se si duhet të kryhet detyra. E testuara bënë disa tentime provuese.

Foto 14. Kërcim së gjati nga vendi (MKGJAT)



3. Tapingu me dorë – MSHTDO

Instrumentet: banka, karriga, dy pllaka nga letra e trashë me diametër 20cm, në largësi 61 cm nga njëri-tjetri (skajet e brendshme), shirit ngjitës të dukshëm dhe kronometri.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari ka qëndruar i kthyer me fytyrë kah matësi i kohës, ku ka qëndruar i ulur në karrige me duar të vendosura mbi bankë (njëra dorë në mes kurse tjetra në – në pllakën e djathtë). Pas disa tentimeve provuese, i testuari i ka zgjedhë largësinë e duhur nga banka.

Realizimi i detyrës: I testuari qëndron i ulur në karrige dhe vendos dorën më të dobët në bankë në mes të dy rrrathëve, ndërsa dorën tjetër e vendos mbi pllakë. Detyra është që sa më shpejt ta takoj njëri, pastaj pllakën tjetër, në kohë prej 15 sekondash nga momenti i dhënies së komandës “tash”.

Vlerësimi: shënohen të gjitha prekjet e rregullta të cilat matësi i numëron brenda 15 sek. Llogaritet çdo takim i dy pllakave (një cikël).

Udhëzime të testuarit: Të testuarve udhëzimet iu jepen gjatë demonstrimit të detyrës,

Foto 15. Tapingu me dorë (MSHTDO)



4. Vrapimi në tetëshe me përkulje – MKTPER

Instrumentet: Kronometri, dy shtylla dhe një litar 5 m i gjatë. Shtyllat vendosen larg njëra-tjetrës në largësi 4 m dhe në to lidhet litari në lartësi të pikës më të lartë të ashtit të legenit të subjektit (lartësia e litarit rregullohet me secilin subjekt veçmas).

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari qëndron pranë njëres shtyllë në qëndrim të nisjes së lartë dhe në shenjën “tash”, nisët me shpejtësinë më të madhe të mundshme, duke kaluar nën litar, arrin deri të shtylla tjetër, rrotullohet rreth saj, dhe përsëri vrapon në drejtim të shtyllës tjetër duke u futur nën litar.

Realizimi i detyrës: I testuari nga momenti i dhënies së komandës “tash” ka për detyrë që distancën 4 m ta kalojë 6 herë (ose nga 3 herë duhet të rrotullohet rreth secilës shtyllë).

Vlerësimi: Rezultati shënohet në saktësi prej 1/10 sec.

Udhëzime të testuarit: Të testuarve udhëzimet iu open gjatë demonstrimit të detyrës,

Foto 16. Vrapimi në tetëshe me përkulje (MKTPER)



7. Fleksibiliteti në bankë (përkulje para) – MFPERK

Instrumentet: Banak, metri milimetrikë i plastikes e përforcuar për drrase të gjatë 80 cm dhe të gjerë 10 cm.

- **Përshkrimi i detyrës:**

- **Pozita fillestare:** I testuari qëndron mbi ulësen suedeze, me këmbë të drejta, në përkulje të thellë të trupit dhe me fytyrë nga drejtimi i përkuljes.

- **Realizimi** i detyrës: I testuari në përkulje të thellë dhe këmbë të drejta, në maje te gishtërinjve të dy shuplakave të cilat janë paralelisht njëra me tjetrën, të prekin sa më thellë metrin. Detyra përsëritet dy herë. I testuari e mban pozitën e fundit që leximi te jetë sa më i saktë.

- **Vlerësimi:** Shënohet rezultati i përkuljes më të thellë i shënuar me centimetra. Pika zero është në maje të centimetrave, saktësia e matjes 0,5 cm.

- **Udhëzime të testuarit:** Të testuarit iu jepen udhëzime gjatë demonstrimit të detyrës.

Foto 17. Fleksibiliteti në bankë (përkulje para) (MFPERK)



4.6 METODAT E PËRPUNIMIT TË REZULTATEVE

Në mënyrë që kërkimi shkencor që të jep zgjidhje të kënaqshme, është e nevojshme që të përdoren procedurat e duhura, të drejta dhe komparative e që janë të natyrës së atij problemi të dhënë.

Duke marrë parasysh të gjitha këto fakte, për qëllimet e këtij hulumtimi janë zgjedhë procedurat për të cilat konsiderohet se korrespondojnë me natyrën e problemeve që hulumtohen.

Për çdo variabël antropometrike, janë llogaritur vlerat e mëposhtme:

1. Parametrat qendrore themelor dhe të shpërndarjes:

- Mesatarja aritmetikore (Ma)
- Devijimi standard (Ds)
- Vlera minimale (Min)
- Vlera maksimale (Max)

2. Lakorja e distribucionit ose e shpërndarjes është testuar me anë të koeficientit të asimetrisë („**skjunis**”), dhe shkalla e lakimit e majës së kurbës ("**kurtozis**"). Normaliteti i distribucionit të çdo variable është testuar me anë të testit të Kolmogorovit-Smirnovit (Ko-Sm) dhe Shapirowit dhe Wilksit (Sha-Wi).

4. Analiza univariante e variaces – ANOVA. Për qëllim të hulumtimit do të na shërbej koeficienti i dallimit Scheffe.

5. INTERPRETIMI DHE DISKUTIMI

5.1 INTERPRETIMI I PARAMETRAVE THEMELOR STATISTIKOR

5.1.1 Interpretimi i parametrave themelor statistikor ndryshoreve antropometrike dhe motorike te fëmijët e moshës 12 vjeçare të gjinisë mashkullore

Parametrat themelor statistikor ndryshoreve antropometrike dhe motorike te fëmijët e moshës 12 vjeçare të gjinisë mashkullore janë të paraqitur në tabelën 1. Në këtë tabelë vërejm se 6 ndryshore antropometrike dhe 4 ndryshore motorike kanë shmangie nga distribucioni normal. Fëmijët e gjinisë mashkullore në këtë moshë paraqiten me zhvillim jo të barabart sa i përket zhvillimit morfologjik dhe motorik.

Tabela 1. Parametrat themelor statistikor ndryshoreve antropometrike dhe motorike te fëmijët e moshës 12 vjeçare të gjinisë mashkullore

	N	Min	Max	Mean	Std. Dev.	Skew	Kurt	K-S	Sh-W.
ALARTË	30	141.00	173.00	153.2000	7.66272	.612	.564	.043	.176
AGJEKR	30	136.00	180.00	151.9333	10.76371	.632	.052	.163	.217
AGJAKË	30	75.00	102.00	89.3667	6.36523	-.362	.104	.200*	.272
APESHA	30	32.00	85.00	48.3333	15.48377	1.229	.725	.017	.001
APEGJO	30	63.00	108.00	76.9333	13.03029	1.197	.617	.026	.001
APEKRA	30	18.00	34.00	23.0000	4.86366	1.015	.114	.004	.001
ADIBYL	30	4.30	5.60	4.9267	.33211	-.293	-.391	.067	.230
ADIBRY	30	5.30	7.50	6.1333	.60705	.700	-.098	.200*	.084
ADIGJU	30	5.90	9.70	8.0500	.90848	-.470	.784	.110	.113
AIDHSH	30	5.00	43.00	13.2000	10.44988	1.848	2.846	.000	.000
AIDHKR	30	4.00	45.00	15.4333	9.79684	1.829	4.105	.004	.000
AIDHBA	30	4.00	41.00	16.5000	12.47549	1.203	-.030	.001	.000
MSVR30L	30	5.01	7.45	6.0713	.55647	.457	1.369	.015	.042
MFKGJVE	30	110.00	190.00	153.3667	20.00256	-.449	.310	.004	.124
MSTDORË	30	21.00	35.00	30.5667	3.74795	-.920	-.191	.001	.002
MATEPËR	30	12.66	18.46	15.1610	1.42319	.836	1.044	.000	.005
MFPPARA	30	20.00	50.00	39.1333	5.87210	-1.054	2.433	.009	.009

5.1.2 Interpretimi i parametrave themelor statistikor ndryshoreve antropometrike te fëmijët e moshës 12 vjeçare të gjinisë femërore

Parametrat themelor statistikor ndryshoreve antropometrike dhe motorike te fëmijët e moshës 12 vjeçare të gjinisë femërore janë të paraqitur në tabelën 2. Në këtë tabelë vërejm se 5 ndryshore antropometrike dhe një ndryshore motorike kanë shmangie nga distribucioni normal. Fëmijët e gjinisë femërore edhe te kjo moshë paraqiten me zhvillim jo të barabart sa i përket zhvillimit morfologjik dhe motorik, por paraqiten si grupë ma homogjen krahasuar me fëmijët e gjinisë mashkullore të kësaj moshe.

Tabela 2. Parametrat themelor statistikor ndryshoreve antropometrike dhe motorike te fëmijët e moshës 12 vjeçare të gjinisë femërore

	N	Min	Max	Mean	Std. Dev.	Skew	Kurt	K-S	Sh-W.
ALARTË	30	137.00	166.00	154.2333	7.60981	-.360	.078	.200*	.174
AGJEKR	30	125.00	166.00	151.1667	10.20170	-.742	1.255	.108	.011
AGJAKË	30	82.00	102.00	91.8333	5.12656	-.134	-.111	.200*	.360
APESHA	30	27.00	70.00	46.3333	9.58207	.483	1.446	.115	.050
APEGJO	30	58.00	88.00	75.8500	7.14523	-.730	1.083	.200*	.099
APEKRA	30	17.50	27.00	22.5667	2.47656	-.186	-.194	.200*	.705
ADIBYL	30	4.20	5.90	4.7833	.34550	.914	2.496	.200*	.064
ADIBRY	30	4.50	6.50	5.8867	.41666	-1.195	2.821	.000	.005
ADIGJU	30	5.70	8.70	7.7067	.71964	-.994	1.388	.041	.021
AIDHSH	30	6.00	19.00	12.5667	3.87462	-.139	-1.189	.003	.080
AIDHKR	30	6.00	24.00	14.9667	5.00678	.366	-.287	.038	.040
AIDHBA	30	5.00	28.00	15.6333	6.21169	.124	-.601	.200*	.342
MSVR30L	30	5.25	8.02	6.4990	.64089	.249	-.098	.200*	.687
MFKGJVE	30	120.00	180.00	141.6667	15.68072	.643	-.062	.019	.053
MSTDORË	30	24.00	38.00	31.6333	3.89945	-.395	-.280	.025	.043
MATEPËR	30	12.65	18.50	16.0860	1.53261	-.330	-.093	.200*	.217
MFPPARA	30	25.00	58.00	40.2333	8.14283	.252	.138	.095	.393

5.1.3 Interpretimi i parametrave themelor statistikor ndryshoreve antropometrike te fëmijët e moshës 13 vjeçare të gjinisë mashkullore

Parametrat themelor statistikor ndryshoreve antropometrike dhe motorike te fëmijët e moshës 13 vjeçare të gjinisë mashkullore janë të paraqitur në tabelën 3. Në këtë tabelë vërejm se vetëm 2 ndryshore antropometrike dhe dy ndryshore motorike nuk kanë shmangie nga distribucioni normal. Fëmijët e gjinisë mashkullore te kjo moshë paraqiten me zhvillim jo të barabart sa i përket zhvillimit morfologjik dhe motorik, dhe paraqiten si grupë shumë heterogjen krahasuar me fëmijët e gjinisë mashkullore të moshes 12 vjeçare.

Tabela 3. Parametrat themelor statistikor ndryshoreve antropometrike dhe motorike te fëmijët e moshës 13 vjeçare të gjinisë mashkullore

	N	Min	Max	Mean	Std. Dev.	Skew	Kurt	K-S	Sh-W.
ALARTË	30	157.00	174.00	162.0000	4.58634	1.409	1.409	.000	.000
AGJEKR	30	158.00	186.00	166.7333	7.64710	.990	.748	.011	.002
AGJAKË	30	91.00	101.00	95.8333	3.62066	.256	-1.445	.001	.003
APESHA	30	41.00	75.00	55.9333	9.59502	.088	-.802	.036	.058
APEGJO	30	60.00	90.00	77.5667	9.51109	-.455	-.642	.102	.008
APEKRA	30	22.00	29.00	25.8000	2.24990	-.589	-.769	.000	.002
ADIBYL	30	4.20	6.00	5.0867	.57639	-.174	-1.289	.000	.004
ADIBRY	30	5.00	6.90	6.2633	.62228	-.890	-.693	.000	.000
ADIGJU	30	6.00	8.30	7.1333	.71792	.330	-.948	.021	.013
AIDHSH	30	5.00	16.00	11.0667	3.96479	-.373	-1.650	.000	.000
AIDHKR	30	6.00	21.00	13.1333	4.62924	.371	-1.044	.000	.003
AIDHBA	30	6.00	30.00	15.0667	7.62000	.490	-.705	.059	.012
MSVR30L	30	5.46	6.76	6.1303	.38410	.088	-.946	.199	.128
MFKGJVE	30	140.00	190.00	167.6667	16.95498	-.290	-1.192	.004	.010
MSTDORË	30	25.00	35.00	31.8000	2.57843	-.979	1.431	.019	.003
MATEPËR	30	12.81	16.83	14.3373	1.05316	.716	.323	.152	.040
MFPPARA	30	24.00	42.00	33.4333	5.76962	-.144	-1.121	.105	.057

5.1.4 Interpretimi i parametrave themelor statistikor ndryshoreve antropometrike te fëmijët e moshës 13 vjeçare të gjinisë femërore

Parametrat themelor statistikor ndryshoreve antropometrike dhe motorike te fëmijët e moshës 13 vjeçare të gjinisë femërore janë të paraqitur në tabelën 4. Në këtë tabelë vërejm se të gjitha ndryshoret antropometrike dhe ndryshoret motorike kanë shmangie nga distribucioni normal. Fëmijët e gjinisë femërore te kjo moshë paraqiten me zhvillim jo të barabart sa i përket zhvillimit morfologjik dhe motorik, dhe paraqiten si grupë shumë heterogjen krahasuar me fëmijët e gjinisë femërore të moshes 12 vjeçare.

Tabela 4. Parametrat themelor statistikor ndryshoreve antropometrike dhe motorike te fëmijët e moshës 13 vjeçare të gjinisë femërore

	N	Min	Max	Mean	Std. Dev.	Skew	Kurt	K-S	Sh-W.
ALARTË	30	148.00	169.00	159.7667	7.30462	.074	-1.311	.000	.001
AGJEKR	30	146.00	171.00	159.5667	8.51645	.062	-1.288	.005	.003
AGJAKË	30	91.00	104.00	97.5333	4.05763	.221	-1.002	.010	.022
APESHA	30	37.00	65.00	52.0667	10.32885	-.070	-1.636	.008	.001
APEGJO	30	70.00	93.00	79.7333	7.41356	.494	-.910	.024	.017
APEKRA	30	20.00	28.00	24.3000	2.73105	-.208	-1.398	.024	.006
ADIBYL	30	4.20	5.20	4.7100	.38805	.075	-1.893	.000	.000
ADIBRY	30	5.10	6.30	5.8133	.44855	-.593	-1.168	.000	.000
ADIGJU	30	5.50	7.30	6.5500	.63450	-.208	-1.192	.001	.002
AIDHSH	30	7.00	15.00	10.4333	2.56882	.723	-.632	.000	.001
AIDHKR	30	7.00	21.00	13.4667	4.76867	.129	-1.414	.038	.010
AIDHBA	30	8.00	21.00	14.9333	4.22581	-.303	-1.112	.186	.028
MSVR30L	30	6.20	8.20	6.9457	.62001	.877	-.321	.000	.001
MFKGJVE	30	120.00	170.00	144.6667	17.16720	-.268	-1.113	.000	.001
MSTDORË	30	29.00	34.00	30.7667	1.63335	.759	-.159	.002	.001
MATEPËR	30	14.02	17.46	15.6963	.95319	-.099	-.295	.000	.013
MFPPARA	30	23.00	40.00	34.6000	5.22989	-.930	.220	.023	.001

5.1.5 Interpretimi i parametrave themelor statistikor ndryshoreve antropometrike te fëmijët e moshës 14 vjeçare të gjinisë mashkullore

Parametrat themelor statistikor ndryshoreve antropometrike dhe motorike te fëmijët e moshës 14 vjeçare të gjinisë mashkullore janë të paraqitur në tabelën 5. Në këtë tabelë vërejm se vetëm 3 ndryshore antropometrike dhe 2 ndryshore motorike nuk kanë shmangie nga distribucioni normal. Fëmijët e gjinisë mashkullore edhe te kjo moshë paraqiten me zhvillim jo të barabart sa i përket zhvillimit morfologjik dhe motorik, dhe paraqiten si grupë shumë heterogjen krahasuar me fëmijët e gjinisë mashkullore të moshes 13 vjeçare.

Tabela 5. Parametrat themelor statistikor ndryshoreve antropometrike dhe motorike te fëmijët e moshës 14 vjeçare të gjinisë mashkullore

	N	Min	Max	Mean	Std. Dev.	Skew	Kurt	K-S	Sh-W.
ALARTË	30	154.00	183.00	167.1667	7.67029	.153	-.516	.200*	.505
AGJEKR	30	156.00	187.00	169.7333	8.34569	.194	-.700	.023	.282
AGJAKË	30	88.00	110.00	98.4667	5.06328	.788	.885	.000	.000
APESHA	30	36.00	91.00	63.0000	13.51372	.264	.729	.029	.025
APEGJO	30	63.00	98.00	83.8667	8.98556	-.722	.407	.082	.115
APEKRA	30	21.00	93.00	30.7333	17.17443	3.477	11.345	.000	.000
ADIBYL	30	4.00	5.10	4.5747	.39881	.068	-1.465	.007	.003
ADIBRY	30	5.02	6.30	5.7200	.47142	-.687	-1.463	.000	.000
ADIGJU	30	7.02	9.40	7.6380	.51923	1.126	2.987	.014	.000
AIDHSH	30	4.00	31.00	9.6000	5.46210	2.622	7.983	.000	.000
AIDHKR	30	4.00	30.00	12.3000	6.49748	1.694	2.445	.000	.000
AIDHBA	30	2.90	35.00	10.8600	7.07748	1.927	4.339	.000	.000
MSVR30L	30	5.23	9.46	6.0450	1.02623	2.586	7.197	.000	.000
MFKGJVE	30	100.00	220.00	155.4333	35.69766	-.019	-1.180	.200*	.100
MSTDORË	30	20.00	40.00	32.4667	5.25051	-.895	.652	.007	.016
MATEPËR	30	13.05	18.11	14.9267	1.08494	1.496	3.711	.012	.001
MFPPARA	30	32.00	44.00	38.6667	3.31489	-.410	-.348	.022	.087

5.1.6 Interpretimi i parametrave themelor statistikor ndryshoreve antropometrike te fëmijët e moshës 14 vjeçare të gjinisë femërore

Parametrat themelor statistikor ndryshoreve antropometrike dhe motorike te fëmijët e moshës 14 vjeçare të gjinisë femërore janë të paraqitur në tabelën 6. Në këtë tabelë vërejm se të gjitha ndryshoret antropometrike dhe 4 ndryshore motorike kanë shmangie nga distribucioni normal. Domethënë vetëm një ndryshore motorike nuk ka shmangie nga distribucioni normal. Fëmijët e gjinisë femërore te kjo moshë paraqiten me zhvillim jo të barabart sa i përket zhvillimit morfologjik dhe motorik, dhe paraqiten si grupë shumë heterogjen krahasuar me fëmijët e gjinisë femërore të moshes 13 vjeçare.

Tabela 6. Parametrat themelor statistikor të ndryshoreve antropometrike dhe motorike te fëmijët e moshës 14 vjeçare të gjinisë femërore

	N	Min	Max	Mean	Std. Dev.	Skew	Kurt	K-S	Sh-W.
ALARTË	30	145.00	165.00	158.2000	6.03095	-1.121	.386	.000	.000
AGJEKR	30	147.00	168.00	159.2000	7.07302	-.233	-1.258	.005	.010
AGJAKË	30	83.00	98.00	92.5000	4.81914	-.764	-.556	.004	.003
APESHA	30	40.00	62.00	54.2000	6.69740	-.737	-.103	.043	.009
APEGJO	30	80.00	90.00	84.6000	3.12498	.421	-.921	.005	.017
APEKRA	30	22.00	28.00	25.2000	1.86437	-.004	-.661	.056	.020
ADIBYL	30	4.01	4.80	4.4610	.23959	-.267	-.499	.037	.029
ADIBRY	30	5.03	6.00	5.3620	.42718	.883	-1.258	.000	.000
ADIGJU	30	7.20	8.30	7.8420	.32654	-.681	-.555	.000	.002
AIDHSH	30	6.00	19.00	11.1000	3.87165	.641	-.352	.200*	.038
AIDHKR	30	7.00	17.00	11.4000	3.12498	.320	-.972	.015	.045
AIDHBA	30	8.00	18.00	12.2000	3.27372	.549	-1.104	.000	.003
MSVR30L	30	6.01	7.50	6.5780	.42252	.676	.409	.159	.008
MFKGJVE	30	97.00	170.00	127.2000	20.72879	.626	-.113	.070	.026
MSTDORË	30	22.00	38.00	30.6000	4.90320	-.243	-.887	.078	.058
MATEPËR	30	14.30	17.33	15.9910	.91407	-.697	-.210	.000	.001
MFPPARA	30	32.00	45.00	39.0000	3.21634	-.360	1.177	.004	.002

5.1.7 Interpretimi i parametrave themelor statistikor ndryshoreve antropometrike te fëmijët e moshës 15 vjeçare të gjinisë mashkullore

Parametrat themelor statistikor ndryshoreve antropometrike dhe motorike te fëmijët e moshës 15 vjeçare të gjinisë mashkullore janë të paraqitur në tabelën 7. Në këtë tabelë vërejm se vetëm 3 ndryshore antropometrike dhe dhe një ndryshore motorike nuk kanë shmangie nga distribucioni normal. Fëmijët e gjinisë mashkullore edhe te kjo moshë paraqiten me zhvillim jo të barabart sa i përket zhvillimit morfologjik dhe motorik, dhe paraqiten si grupë shumë heterogjen krahasuar me fëmijët e gjinisë mashkullore të moshes 14 vjeçare.

Tabela 7. Parametrat themelor statistikor të ndryshoreve antropometrike dhe motorike te fëmijët e moshës 15 vjeçare të gjinisë mashkullore

	N	Min	Max	Mean	Std. Dev.	Skew	Kurt	K-S	Sh-W.
ALARTË	30	160.00	185.00	171.2667	5.98235	.122	-.275	.081	.137
AGJEKR	30	161.00	190.00	174.4667	7.03064	.126	.131	.200*	.643
AGJAKË	30	85.00	109.00	102.6000	5.01446	-1.557	3.933	.002	.001
APESHA	30	46.00	88.00	62.2000	7.43431	1.037	4.429	.006	.006
APEGJO	30	38.50	94.00	84.2833	9.98420	-3.474	15.690	.000	.000
APEKRA	30	21.00	31.00	25.6833	2.33594	.297	-.395	.047	.414
ADIBYL	30	3.90	5.60	4.7400	.45075	.338	-.459	.028	.034
ADIBRY	30	4.10	7.20	6.5400	.57631	-2.614	10.720	.000	.000
ADIGJU	30	7.00	9.10	7.8833	.43556	.191	1.497	.000	.012
AIDHSH	30	7.00	14.00	10.9000	1.95378	-.355	-.986	.052	.029
AIDHKR	30	6.00	14.00	10.5333	2.52891	-.213	-1.120	.029	.036
AIDHBA	30	7.00	16.00	12.2000	2.74678	-.459	-.949	.003	.014
MSVR30L	30	4.98	6.31	5.5220	.31978	.549	-.078	.008	.157
MFKGJVE	30	140.00	220.00	191.8333	20.94670	-.807	-.057	.001	.009
MSTDORË	30	27.00	49.00	34.5000	4.29715	1.098	3.509	.014	.007
MATEPËR	30	5.20	15.76	10.7750	4.28306	-.375	-1.871	.000	.000
MFPPARA	30	21.00	56.00	41.5000	8.56517	-.790	-.111	.022	.020

5.1.8 Interpretimi i parametrave themelor statistikor ndryshoreve antropometrike te fëmijët e moshës 12 vjeçare të gjinisë femërore

Parametrat themelor statistikor ndryshoreve antropometrike dhe motorike te fëmijët e moshës 14 vjeçare të gjinisë femërore janë të paraqitur në tabelën 6. Në këtë tabelë vërejm se te 5 ndryshore antropometrike dhe 4 ndryshore motorike kanë shmangie nga distribucioni normal. Domethënë vërejm një ndryshim në zhvillimin morfologjik, ose një zvoglim sa i përket ndryshimeve në zhvillimin morfologjik. Fëmijët e gjinisë femërore edhe te kjo moshë paraqiten me zhvillim jo të barabart sa i përket zhvillimit morfologjik dhe motorik, dhe paraqiten si grupë heterogjen, por, më homogjen krahasuar me fëmijët e gjinisë femërore të moshes 14 vjeçare.

Tabela 8. Parametrat themelor statistikor të ndryshoreve antropometrike dhe motorike te fëmijët e moshës 15 vjeçare të gjinisë femërore

	N	Min	Max	Mean	Std. Dev.	Skew	Kurt	K-S	Sh-W.
ALARTË	30	150.00	180.00	162.1667	7.29706	.729	.901	.008	.053
AGJEKR	30	140.00	183.00	162.4000	9.00038	.429	1.294	.079	.067
AGJAKË	30	90.00	104.00	98.1000	3.78153	-.460	-.273	.074	.209
APESHA	30	48.00	72.00	57.4333	5.84090	.737	.365	.045	.074
APEGJO	30	77.00	107.00	89.9500	8.61769	.380	-.803	.064	.187
APEKRA	30	20.00	33.50	26.6000	3.39726	.360	.406	.001	.018
ADIBYL	30	3.80	4.50	4.2000	.25189	-.097	-1.563	.009	.002
